



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OSMANI: SERBIA DHE RUSIA KËRCËNIM PËR KOSOVËN, BE TË MOS E SHPËRBLEJË BEOGRADIN

FAQE 4



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha se Rusia dhe aleatja e saj, Serbia, paraqesin kërcënime për Kosovën, duke i bërë thirrje Bashkimit Evropian të mos "e

shpërbëjë Beogradin". Para nisjes së samitit të Komunitetit Politik Evropian në Kopenhagë të Danimarkës, Osmani tha për gazetarët se Rusia paraqet

kërcënim për Evropën, ndërkaq Serbia për rajonin e Ballkanit Perëndimor, duke e akuzuar Beogradin se i kopjon veprimet e Moskës

AKTUALE



**MACRONI KËRKON RITJE
TË PRESIONIT NDAJ "FLOTËS
NË HIJE" TË RUSISË** F.2

**JOSEPH THOTË SE PEZULLIMI I
DIALOGUT STRATEGJIK ËSHTË HAP
SHUMË SERIOZ I SHBA-së** F.5

**KURTI: VOTIMI PËR EMILIJA
REXHEPIN NUK MUND
TË ANULOHE** F.3

**RRITET NORMA E INTERESIT, BIE
NUMRI I DHËNIES SË KREDIVE NË
KOSOVË, SHKAK INFLACIONI DHE
MOSKRIJIMI I INSTITUCIONEVE** F.7

EKONOMI

**DIASPORA E KOSOVËS SOLLI RRETH
928 MILIONË EURO PËR TETË
MUAJT E PARË TË 2025-s** F.8

**ÇMIMI I ARIT ARRIN NIVELIN MË TË
LARTË NË HISTORI** F.8

SPORT



**ADEMI: KOSOVËN E SHOH
TË KUALIFIKUAR NË EURO 2028,
FANELLA E KOMBËTARES KA BARRËN
E GJAKUT DHE SAKRIFICËS** F.11

**PËRFUNDON
DËSHMINË NË
HAGË NJERIU
MË I AFËRT I
BERNARD
KOUCHNERIT** F.4



**640 RASTE
TË REJA ME
KANCER TË
GJIRIT NË
KOSOVË GJATË
VITIT 2024** F.5



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princsha-ks.com

Buniamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

MACRONI KËRKON RRITJE TË PRESIONIT NDAJ “FLOTËS NË HIJE” TË RUSISË

PARIS, 2 TETOR - Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, i bëri thirrje Evropës të ndërmarrë veprime të koordinuara ndaj së ashtuquajturës “flotë në hije” të Rusisë dhe ta ndjekë shembullin e Francës për t'i penguar këto anije që përdoren për t'i shmangur sanksionet perëndimore. Franca aktualisht po heton një anije, të regjistruar në Benin, që dyshohet se është pjesë e qindra cisternave të vjetra, të futura në listën e sanksioneve nga Bashkimi Evropian nën akuza se po ndihmojnë Moskën për shmangien e kufizimeve për eksportet e naftës pas pushtimit të Ukrainës më 2022. “Është jashtëzakonisht e rëndësishme që

të rritet presioni për këtë ‘flotë në hije’, sepse qartësisht do ta reduktonte kapacitetin financiar për këtë luftë”, tha Macroni para udhëheqësve të mbledhur në Danimarkë. Udhëheqësi francez sugjeroi që shtetet evropiane që janë pjesë e “koalicionit të vullnetit” - për mbështetjen e Kievit - duhet të koordinohen me NATO-n “për një veprim të përbashkët” sa i përket kësaj çështjeje. Autoritetet franceze kanë arrestuar dy pjesëtarë të Boracay, anijes që gjendet në pjesën perëndimore të brigjeve të Francës, dhe nisën hetimin mbi “dështimin e ekuipazhit për ta justifikuar nacionalitetin e anijes dhe

refuzimit për të bashkëpunuar”. Të dhënat nga gjurmimi i anijeve tregojnë se cisterna ka qenë pranë bregut danez muajin e kaluar, kur kishte fluturime misterioze të dronëve që rritën shqetësimet për sigurinë dhe detyruan autoritetet e Danimarkës që të mbyllnin aeroporte. Mediet e kanë lidhur veprimin e Francës me fluturimet e dronëve, por kjo nuk është konfirmuar nga Parisi. Macroni tha se, përveç sigurimit që anijet t'i respektojnë rregullat ndërkombëtare, ndalime të tilla janë “shumë të rëndësishme” për ta rritur presionin ndaj Moskës, për t'i goditur të ardhurat që i përdorë për luftën kundër Ukrainës dhe



për ta detyruar që të negociojë. “Flota në hije”, që besohet se përfshin deri në 1 000 anije, përfaqëson “dhjetëra miliarda

euro të buxhetit të Rusisë” dhe “përbën 40 për qind të përpjekjes së saj luftarake”, tha udhëheqësi francez.

DY TË VRARË NË NJË SULM AFËR NJË SINAGOGE NË MANÇESTER

MANÇESTER, 2 TETOR - Dy njerëz janë vrarë të enjten pasi një sulmues i shkeli me veturë këmbësorët dhe e theri me thikë një roje sigurie pranë një sinagoge në Mançester të Anglisë, njoftoi policia britanike. Sulmi ndodhi gjatë Jom Kipurit, ditës më të shenjtë në kalendarin hebraik. Policia e Mançesterit tha se oficerët e kanë qëlluar të dyshuarin pasi u thirrën në vendngjarje pranë Sinagogës së Kongregacionit Hebraik, Heaton Park, në qarkun Krumpsall në veri të Anglisë. Policia ndërhyri pasi një dëshmitar tha se një makinë kishte përplasur kalimtarët dhe se një burrë ishte therur me thikë. Besohet se i dyshuari ka vdekur, por oficerët thanë se nuk mund ta konfirmojnë këtë “për shkak të çështjeve të sigurisë lidhur me sende të dyshimta që kishte me vete”. Përveç dy personave që janë



konfirmuar të vdekur, tre të tjerë janë në gjendje të rëndë. Në vendngjarje janë parë forca të shtuara të policisë, po ashtu janë parë edhe ekipe të emergjencave. Një video e publikuar në rrjetet sociale shfaqti policinë duke e qëlluar një person brenda perimetrit të sinagogës, ndërsa një tjetër i plagosur u pa i shtrirë

dhe dukej se kishte të veshur rroba tradicionale hebraike. “Jam i tmerruar nga sulmi në sinagogën në Krumpsall”, tha kryeministri britanik Keir Starmer në X. Për shkak të kësaj ngjarjeje, ai ndërpreu pjesëmarrjen në samitin e Komunitetit Evropian Politik. “Fakti që kjo ndodhi në Jom Kipur, në ditën më të shenjtë

të kalendarit hebraik, e bën këtë ngjarje edhe më të tmerrshme”, shtoi Starmer. Ndërkaq, kryetari i Mançesterit, Andy Burnham, tha se ky ishte një incident serioz. “U bëj thirrje njerëzve ta shmangin këtë zonë. Ky është incident serioz, në të njëjtën kohë mund t'u japim siguri njerëzve se rreziku duket se ka kaluar dhe se policia në

Mançester e ka trajtuar shumë shpejt” këtë rast, tha ai për radion BBC. Jom Kipuri është dita më e shenjtë në kalendarin hebraik kur besimtarët shkojnë në sinagoga për t'u lutur. Vitin e kaluar Britania shënoi më shumë se 3 500 incidente antisemitike. Këto incidente u rritën pas nisjes së luftës në Gazë më 7 tetor 2023, kur Hamasi - grupi palestinez i shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe BE-ja - sulmoi jugun e Izraelit, duke nxitur luftën në enklavën palestineze. Britania, po ashtu, ka përjetuar një sërë sulmesh të kryera nga militantët islamikë që nga sulmet terroriste më 11 shtator 2001 në ShBA. Më 2017, një sulm vetëvrasës me bombë ndodhi gjatë koncertit të Ariana Grande në Mançester. Po ashtu, vitet e fundit policia ka paralajmëruar lidhur me kërcënimin e terrorizmit nga ekstremi i djathtë.

IZRAELI THOTË SE DO T'I DËBOJË AKTIVISTËT NË FLOTËN E NISUR DREJT GAZËS

JERUSALEM, 2 TETOR - Ministria e Jashtme e Izraelit tha se do t'i dëbojë në Evropë aktivistët propalestinezë që gjenden në anijet e flotës Global Sumud, që u ndaluan nga forcat izraelite. “Pasagjerët e Sumudit të Hamasit [grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian] janë nisur drejt Izraelit, ku do t'u nënshtrohen procedurave të dëbimit në Evropë. Pasagjerët janë të sigurt dhe në gjendje të mirë shëndetësore”, tha ministria në X,

pasi forcat izraelite ndaluan disa anije me ndihma që ishin nisur drejt Gazës. Forcat izraelite kanë ndaluar 14 anije që po bartnin aktivistë të huaj dhe ndihmë dedikuar Gazës, por edhe 23 anije po vazhdojnë lundrimin drejt enklavës palestineze, thanë organizatorët e flotës më 2 tetor. Në një video të publikuar më herët nga Ministria e Jashtme e Izraelit shihen shumica e aktivistëve më të njohur që po lundrojnë me këto anije, përfshirë edhe aktivisten suedeze për

klimën, Greta Thunberg, të ulur në anije dhe të rrethuar nga ushtarët. “Disa anije të flotës Sumud të Hamasit janë ndaluar dhe pasagjerët e tyre po transferohen në një port të Izraelit”, tha Ministria e Jashtme në X më herët gjatë 2 tetorit. “Greta dhe miqtë e saj janë të sigurt dhe me shëndet të plotë”. Flota Global Sumud, që po transporton ilaçe dhe ushqime për në Gazë, përbëhet nga më shumë se 40 anije civile dhe afër 500 ligjvënës, avokatë dhe aktivistë.



Osmani takon Rutten, flasin për sigurinë në Kosovë dhe Ballkanin Perëndimor

PRISHTINË, 2 TETOR - Presidentja Vjosa Osmani ka takuar sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Mark Rutte, në Samitin e EPC në Danimarkë.

Osmani ka thënë se ky takim ishte një mundësi e shkëlqyer për ta riafirmuar gatishmërinë tonë për koordinim të rregullt në mbrojtje të paqes dhe

sigurisë në Kosovë dhe gjithë Ballkanin Perëndimor. Presidentja Osmani ka theksuar, po ashtu, rolin vendimtar të NATO-s pnrë

garantimin e stabilitetit rajonal si dhe përkushtimin e Kosovës për të qenë partnere e besueshme në përballjen me sfidat e përbashkëta.



KURTI: VOTIMI PËR EMILIJA REXHEPIN NUK MUND TË ANULOHE

PRISHTINË, 2 TETOR - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se zgjedhja e Emilija Rexhepit nënkryetare e Kuvendit të Kosovës nga minoriteti joserb “nuk mund të anulohet”, teksa vendi pret aktgjykimin e plotë të gjykatës më të lartë në lidhje me votimin për nënkryetarët e organit ligjvënës. Gjykata Kushtetuese njoftoi më 30 shtator përmes një vendimi se Kuvendi i Kosovës nuk është konstituuar ende dhe se ky proces nuk përfundon pa zgjedhjen e nënkryetarit nga radhët e komunitetit serb. I pyetur nga gazetarët gjatë një ngjarjeje në Prishtinë lidhur me vendimin e gjykatës, Kurti, i cili gjithashtu është lider i Lëvizjes Vetëvendosje, tha se “duhet ta shohim aktgjykimin në mënyrë të plotë për ta dhënë vlerësimin tonë”. Por, ai shtoi se “është humbje kohe dhe dëm që nuk po funksionon Kuvendi i Kosovës. Kuvendi e ka zgjedhur kryetarin, Dimal Bashën, i ka zgjedhur katër nënkryetarët,

Albulena Haxhiun, Vlora Çitakun, Kujtim Shalën dhe Emilija Rexhepin”. “Askush nuk është duke e zënë karrigen e zbrazët për nënkryetarin nga komuniteti serb. Emilija Rexhepi është nënkryetare e Kuvendit. Nuk mundet votimi për Emilija Rexhepin të anulohet. Prandaj ne kemi ngelur vetëm te nënkryetari i fundit nga komuniteti serb”, tha Kurti. Gjykata Kushtetuese nuk e ka publikuar ende aktgjykimin e plotë të 30 shtatorit dhe asaj zakonisht i duhet rreth një javë për ta bërë këtë. Emilija Rexhepi u zgjodh nënkryetare e Kuvendit nga pakica joserbe në një votim ndaras nga pakica serbe në gusht, pavarësisht se në të kaluarën ishin votuar gjithmonë në një pako. Kjo bëri që Lista Serbe - partia më e madhe e serbëve të Kosovës - të ankohej në Kushtetuese për veprimin e kreut të ri të Kuvendit, Dimal Basha, i cili më vonë do ta shpallte organin ligjvënës të konstituuar



pavarësisht prej moszgjedhjes së nënkryetarit nga minoriteti serb.

Gjykata Kushtetuese theksoi se seanca e nisur më 15 prill duhet të përfundojë brenda 12

ditëve nga hyrja në fuqi e aktgjykimit të saj të 30 shtatorit.

RREGULLORJA PËR SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS E AKPPM-së SHPALLET E PALIGJSHME DHE SHFUQIZOHET



PRISHTINË, 2 TETOR - Gjykata Supreme e Kosovës në çështjen juridike në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësve: L. F., A. V., A. L. Z., Xh. I., P. Gj., L. B., H. S., M. R., A. I., S. T., të cilët i përfaqëson Ardian Bajraktari, avokat, sipas autorizimit, kundër të paditurës: Zyra e Kryeministrit dhe Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM), përfaqësuar nga Ministria e Drejtësisë - Avokatura Shtetërore, avokat Bedri Krasniqi, me bazë juridike: shfuqizimin e aktit nënligjor normativ - Rregulloren (ZKM) Nr.04/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe

Sistematizimin e Vendeve të Punës të Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, me kërkesë për caktimin e masës së posaçme/përkohshme të sigurimit, në shqyrtimin gjyqësor publik, të mbajtur në praninë e palëve ndërgjyqëse, më 22 shtator ka aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë e paditësve në fjalë. Është shpallur e paligjshme dhe është shfuqizuar Rregullorja (ZKM) nr. 04/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, e publikuar në

Gazetën Zyrtare më datë 18.04.2025. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve është refuzuar, si në pikën I, me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet e paditura: Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM), me seli në Prishtinë, që ta nxjerrë aktin nënligjor normativ në përputhje me dispozitat ligjore. Po ashtu, është refuzuar kërkesa për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, me të cilën paditësit kanë kërkuar ndalimin e prodhimit të pasojave juridike të Rregullores deri në vendosjen meritore sipas kërkesëpadisë.

Raporti i UNMIK-ut më 21 tetor para Këshillit të Sigurimit

PRISHTINË, 2 TETOR - Seanca e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara rreth raportit gjashtëmujor të sekretarit të përgjithshëm të OKB-së për punën e misionit mbështetës në Kosovë

(UNMIK) do të mbahet më 21 tetor në Nju-Jork të Shteteve të Bashkuara. Zëvendëspërfaqësuesi special i OKB-së, Milbert Dongjoon Shin, do ta paraqesë raportin e UNMIK-ut para përfaqësuesve

të shteteve anëtare të Këshillit të Sigurimit. Seanca e fundit e Këshillit të Sigurimit të OKB-së për Kosovën është mbajtur më 8 prill. Misioni i UNMIK-ut operon në përputhje me Rezolutën 1244

të OKB-së e cila ishte miratuar si kompromis mes shteteve perëndimore dhe Rusisë për t'i dhënë fund luftës në Kosovë. Ky mision, gjithashtu, mban pozicion neutral ndaj pavarësisë së Kosovës.



OSMANI: SERBIA DHE RUSIA, KËRCËNIME PËR KOSOVËN, BE TË MOS E SHPËRBLEJË BEOGRADIN

PRISHTINË, 2 TETOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha se Rusia dhe aleatja e saj, Serbia, paraqesin kërcënime për Kosovën, duke i bërë thirrje Bashkimit Evropian të mos “e shpërbëjë Beogradin”. Para nisjes së samitit të Komunitetit Politik Evropian në Kopenhagë të Danimarkës, Osmani tha për gazetarët se Rusia paraqet kërcënim për Evropën, ndërkaq Serbia për rajonin e Ballkanit Perëndimor, duke e akuzuar Beogradin se i kopjon veprimet e Moskës. “Serbia i trajton shtetet fqinje si shtete që nuk ekzistojnë, si shtete të përkohshme, si shtete ndaj të cilave ajo vepron me agresion. Është kopje e metodave të Rusisë. Fatkeqësisht, Rusia e përkrah Serbinë në këto veprime. Tradicionalisht dhe për shekuj të tërë ata kanë përdorur një koncept të ngjashëm: Rusia flet për ‘Rusinë e Madhe’ dhe ‘Botën Ruse’, Serbia për ‘Serbinë e Madhe’ dhe ‘Botën Serbe’ dhe përdorin të njëjtat metoda. Për ne të dyja paraqesin kërcënime”, tha Osmani. Osmani tha se në rajonin e Ballkanit Perëndimor kurrë nuk ka vakum të ndikimit. Nëse nuk ka ndikim perëndimor, sipas saj, “forcat malinje të ‘Trekëndëshit të Ligësisë’ - që është Rusia, Kina dhe Irani - gjithmonë vijnë aty jo për bamirësi, por kanë interesa dashakeqe strategjike. Prandaj është e rëndësishme që zgjerimi të shtyhet përpara dhe Ballkani Perëndimor, ato shtete të rajonit që i plotësojnë kriteret dhe punojnë me vlerat e BE-së, të merren parasysh që të lëvizin përpara”. Osmani tha se disa ditë më parë Kosova shënoi dyvjetorin e sulmit të armatosur në Banjskë të Zveçanit, kur një grup i serbëve të armatosur sulmoi Policinë e Kosovës dhe vrau një rreshter. Kosova e konsideron këtë sulm

terrorist dhe akuzon shtetin e Serbisë për organizimin e tij. “BE-ja vazhdon të kërkojë llogaridhënie. Ka pasur zero llogaridhënie dhe është koha që ata t’i shndërrojnë fjalët në veprime”, tha Osmani. Sipas saj, presidenti serb, Aleksandar Vuçiq, ka tentuar ta kopjojë udhëheqësin rus, Vladimir Putin, “duke përdorur taktika të agresionit dhe destabilizimit ndaj fqinjëve dhe për këtë arsye është e rëndësishme që shtetet anëtare të BE-së ta kuptojnë se shpërblimi i Serbisë për qëndrimin me Rusinë nuk është rruga përpara. Shtetet që janë harmonizuar 100 për qind me BE-në duhet të shpërblehen, jo ato që kanë zgjedhur Moskën si rrugë përpara”, tha ajo. Serbia mban raporte të mira me Rusinë dhe deri më tani ka refuzuar t’i bashkohet komunitetit ndërkombëtar në sanksionimin e Moskës për shkak të luftës kundër Ukrainës. BE-ja vazhdimisht i ka bërë thirrje Beogradit - që synon të anëtarësohet në bllokun evropian - që të harmonizohet me politikën e jashtme të Brukselit. Duke folur për aplikimin e Kosovës për anëtarësim në BE - që Prishtina e ka dorëzuar në fund të vitit 2022 - Osmani tha se ai nuk është trajtuar ende nga BE-ja për shkak të “politikave të brendshme” të disa shteteve anëtare, por shtoi se Kosova do të vazhdojë të punojë që t’i bindë këto shtete, duke theksuar se “rruga e vetme për Kosovën” është anëtarësimi në BE dhe NATO. Danimarka është mikpritëse e samitit të shtatë të Komunitetit Politik Evropian. Samiti mbledh 45 udhëheqës, përfshirë edhe presidentin e Ukrainës, Volodymyr Zelensky. “Udhëheqësit do të fokusohen se si të forcohet Ukraina, në




situatën e përgjithshme të sigurisë në Evropë dhe për një situatë më të sigurt gjeopolitike me të cilën përballemi”, tha Bashkimi Evropian. Sipas BE-së, gjatë samitit do të mbahen disa tryeza diskutimesh për disa aspekte të situatës së sigurisë në Evropë, përfshirë “kërcënimet tradicionale dhe hibride, sigurinë ekonomike dhe migrimin”. BE-ja në këtë takim do të përfaqësohet nga presidenti i Këshillit Evropian, Antonio Costa, dhe takimi do të bashkudhëhiqet nga kryeministria e Danimarkës, Mette Frederiksen. Nga Presidenca e Kosovës thanë më herët se Komuniteti Politik Evropian synon t’i forcojë lidhjet politike dhe ekonomike në gjithë Evropën, të ofrojë zgjidhje për sfidat e përbashkëta dhe ta thellojë bashkëpunimin ndërmjet vendeve të BE-së dhe atyre jashtë saj. Në agjendën e publikuar nga BE-ja, te shtetet pjesëmarrëse, pas emrit të Kosovës është vendosur fusnota. Më 2012, në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë - që

ndërmjetësohet nga BE-ja - palët arritën një marrëveshje për përfaqësimin rajonal, që më vonë u bë e njohur si “marrëveshja e fusnotës”. Në bazë të kësaj marrëveshjeje, fusnota do t’i shtohet emrit të Kosovës sa herë që vendi do të përmendej, për ta mundësuar përfaqësimin në konferenca e iniciativa të ndryshme rajonale dhe ndërkombëtare. Në vitet pas nënshkrimit të marrëveshjes, emrit të Kosovës i bashkëngjitej gjithnjë edhe simboli i fusnotës në dokumente të Kombeve të Bashkuara, BE-së e institucioneve të tjera ndërkombëtare. Ndryshe, Komuniteti Politik Evropian rrallë vendos për çështje, por duke pasur parasysh se kërret shtetërorë të kontinentit - përjashtim bëjnë ata nga Bjellorusia, Rusia dhe Vatikani - do të mblidhen me një vend për gjashtë apo shtatë orë për takime politike, nga kjo ngjarje mund të dalin përfundime interesante. Përveç sesionit të Komunitetit Politik Evropian dhe kohës për takime dypalëshe, udhëheqësit do të ndahen në tri gupe

punuese për tema që kanë të bëjnë me sigurinë dhe rezistencën: Kërcënimet tradicionale dhe të reja; Siguria ekonomike: Reduktimi i varësive evropiane; dhe Migracioni: kontrolli efektiv i flukseve migratore. Komuniteti Politik Evropian u lansua më 2022 si ide e presidentit të Francës, Emmanuel Macron, pas nisjes së pushtimit rus të Ukrainës, si një lloj forumi ndërqeveritar për diskutime politike lidhur me të ardhmen e Evropës. Në samitin e parë të mbajtur në tetor të vitit 2022 në Pragë, Macroni e hodhi poshtë idenë se ky komunitet është një lloj zëvendësimi për anëtarësimin në BE, duke ua kujtuar këtë udhëheqësve në Ballkanin Perëndimor. Nga Ballkani Perëndimor vetëm Kosova qëndron e fundit në rrugën evropiane, pasi është shteti i vetëm që nuk ka statusin e vendit kandidat. Ndërkaq, Shqipëria dhe Mali i Zi janë shtetet që kanë bërë përparimin më të madh në rrugën drejt bllokut evropian. Tirana synon të bëhet pjesë e BE-së deri më 2030.

PËRFUNDON DËSHMINË NË HAGË NJERIU MË I AFËRT I BERNARD KOUCHNERIT

Hagë, 2 tetor - Jock Covey, ish-zëvendës në UNMIK i Bernard Kouchner, ka dëshmuar për tri ditë në Gjykatën Speciale të Hagës. Mbrojtja e liderëve të UÇK-së ka bërë me dije se nuk do të jenë gati për të përfunduar paraqitjen e provave deri më 14 nëntor, e as dorëzimin e dosjeve finale në dhjetor. Covey në dëshminë e tij ka folur për rolin e Hashim Thaçit, strukturën e UÇK-së, krimet e pretenduara të pasluftës, tensionet ndëretnike dhe tema të tjera. Covey ka deklaruar se raporti i Hashim Thaçit me komandantët kishte qenë i ndërlikuar. Madje, ai ka thënë se komandantët kishin shfaqur mungesë respekti



ndaj Thaçit. “Ai që fliste në emër të UÇK-së, ishte Agim Çeku. Kjo më kujtohet fare qartë sepse dukej që po konfirmonte atë që ne besonim në fillim me z. Thaçin. Që ai kishte

marrëdhënie të ndërlikuar me komandantët në terren, dhe se ata kishin shfaqur mungesë respekti ndaj tij, nuk kishin respekt për të”, ka thënë Covey. Ai është pyetur edhe lidhur me

përfundimin e konfliktit në Kosovë, temë kjo tejte e diskutuar në Gjykatën Speciale. “Konflikti përfundoi me marrëveshjen për tërheqjen e serbëve, që më duket më 20 qershor 1999. Nuk më kujtohet, thjesht ekziston dokumenti. Zbatimi i këtij dokumenti i dha fund edhe konfliktit”, ka thënë ai, duke shtuar se UNMIK-u nuk e ka trajtuar Thaçin si komandat të UÇK-së. Gjatë dëshmisë së tij në Hagë, Covey ka treguar se Hashim Thaçi e kishte dënuar dhunën e ushtruar ndaj pakicave etnike sidomos gjatë verës dhe vjeshtës së vitit 1999. Njeriu më i afërt i Bernard Kouchner, Jock Covey, në ditën e fundit të dëshmisë së tij ka treguar se si e ka njohur

Thaçin. “Në Kosovë neve na u paraqit, shembull konkret, ky njeri i ri, që ishte ndoshta jo shumë i zhvilluar, por shumë ambicioz dhe shumë i zgjuar, me ambicie politike që ishin përtej aftësisë së tij për të imponuar këto ambicie politike. Ne pamë me interes këtë, se si ai po përpiqej të gjente këtë rrugë në të cilën nuk kishte përvojë”, ka thënë Covey. Procesi gjyqësor ndaj Hashim Thaçi, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit ka nisur në prill të vitit 2023. Ata janë duke u mbajtur në paraburgim që nga nëntori i vitit 2020. Katërshtja e UÇK-së është deklaruar e pafajshme në raport me akuzat me të cilat i ka ngarkuar Prokuroria e Speciales.

JOSEPHI THOTË SE PEZULLIMI I DIALOGUT STRATEGJIK ËSHTË HAP SHUMË SERIOZ I SHBA-së

PRISHTINË, 2 TETOR - Edward Joseph, ligjërues në Shkollën për Studime të Avancuara në "Johns Hopkins" në Shtetet e Bashkuara dhe vëzhgues i dalluar i zhvillimeve politike në Ballkanin Perëndimor, vlerësoi se Kosova është në një situatë të vështirë, posaçërisht pas pezullimit të dialogut të planifikuar strategjik midis Prishtinës dhe Uashingtonit. Ai citoi Departamentin Amerikan të Shtetit, i cili theksoi se veprimet

e kryeministrit në detyrë të Kosovës, Albin Kurti, çuan në pezullimin e dialogut të planifikuar strategjik, i cili është niveli më i lartë i diskutimit për thellimin e partneritetit me ShBA-në. "Ky është një hap shumë serioz. Ata përmendën konkretisht kryeministrin në detyrë Kurti, deklaratat dhe veprimet e tij. Dhe ata vunë në dukje se veprimet dhe deklaratat e tij kërcënuan progresin e arritur me shumë vështirësi",

kujtoi Joseph.

Kosova ka gëzuar mbështetjen e secilës administratë amerikane përgjatë dekadave, pavarësisht kush ka qenë banor i Shtëpisë së Bardhë. Por, marrëdhëniet mes Prishtinës dhe Uashingtonit kanë përjetuar një valë sizmike tensionesh dhe mosmarrëveshesh vitet e fundit, të cilat kanë filluar pas ardhjes së Kurtit në pushtet në Kosovë.

Joseph shtoi se shpreson që

vizita e krerëve shtetërorë të Kosovës në ShBA, në kuadër të javës së nivelit të lartë të Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës Kombeve të Bashkuara, të ketë shërbyer për t'i çuar përpara interesat e Kosovës. "Nuk di asgjë për aktivitetet e tyre. Unë shpresoj vetëm që të gjithë ishin atje për t'i çuar përpara interesat e Kosovës - një vend i vogël që ka nevojë për ShBA-në, pavarësisht se kush është në krye. Kosova ka

nevojë për ShBA-në, si mike dhe partnere".

Raportet në mes të Prishtinës dhe Uashingtonit janë dobësuar ndjeshëm, kryesisht për shkak të bindjes së administratës amerikane se Albin Kurti nuk ka treguar gatishmëri për bashkëpunim gjatë mandatit të tij në krye të qeverisë, pavarësisht prej thirrjeve, rekomandimeve dhe përkushtimit amerikan ndaj Kosovës.



640 RASTE TË REJA ME KANCER TË GJIRIT NË KOSOVË GJATË VITIT 2024

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 TETOR - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, mori pjesë në hapjen e fushatës sensibilizuese kundër Kancerit të Gjirit, me rastin e fillimit të Muajit të Ndërgjegjësimit Kundër Kancerit të Gjirit, që u organizua nga Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës. Kryeministri Kurti në fjalën hyrëse tha se muaji i vetëdijësimit për kancerin e gjirit është fushatë vjetore ndërkombëtare, që synon edukimin për rëndësinë e shëndetit të gjirit, për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit te gratë dhe burrat në të gjithë botën. "Motoja e fushatës këtë vit është 'Me ty fillon parandalimi', një mesazh i qartë që tregon se secili nga ne ka një rol të rëndësishëm. Me vetëdijësimin dhe me informimin e saktë mbi kujdesin për shëndetin tonë, me vetëkontroll dhe me kontrolle të rregullta mjekësore, ne e bëjmë hapin vendimtar drejt zbulimit të hershëm të sëmundjes dhe shpëtimit të jetës", tha kryeministri Kurti, duke shtuar

se të dhënat tregojnë se në botë çdo vit diagnostikohen mbi 2.3 milionë raste të reja dhe humben rreth 670 mijë jetë nga kanceri i gjirit. Ai tha se në Kosovë vetëm në vitin 2024 janë regjistruar 640 raste të reja, shumica gra, por edhe burra, dhe se ky realitet na obligon që kanceri i gjirit të trajtohet si prioritet kombëtar shëndetësor.

Për këtë qëllim, kryeministri Kurti tha se Ministria e Shëndetësisë, në bashkëpunim me IKShPK-në dhe institucionet shëndetësore në të gjitha nivelet, ka përgatitur një program të gjerë aktivitetesh gjatë gjithë muajit tetor: nga informimi i qytetarëve në sheshe dhe shkolla, te ligjëratat për komunitete të ndryshme, organizimi i mamografisë mobile gjatë tërë muajit në komunat ku nuk ka mamograf, deri tek emisionet edukative në platforma digjitale dhe takimet me gratë që e kanë mposhtur luftën me kancerin.

Më tej, kryeministri theksoi se është investuar në pajisje të teknologjisë së fundit, në infrastrukturë moderne dhe personel të specializuar për trajtim më cilësor, derisa nga fundi i tetorit të vitit 2024,



mamografitë dhe rikonstruktimi i gjirit janë falas përherë në institucionet publike në Kosovë. Për herë të parë është hartuar edhe Plani Kombëtar i Skriningut për Kancerin e Gjirit 2026-2028, plan ky që do të mundësojë qasje më të organizuar, më të drejtë dhe më të barabartë në shërbime për të gjitha gratë, duke siguruar diagnostikim të hershëm dhe më

shumë jetë të shpëtuar. Ndërkaq, ministri në detyrë i Shëndetësisë, Arben Vitia, tha se kjo ngjarje është një nismë që synon ndërgjegjësimin për një sëmundje që prek mijëra gra çdo vit, pa përjashtuar edhe burrat, por që me diagnostikim të hershëm mund të mposhtet. Ai tha se vetëkontrolli, kontrollet e shpeshta në rastet e dyshimeve si

dhe mamografia, janë shumë të rëndësishme për zbulimin e hershëm të kësaj sëmundjeje për parandalimin dhe shërimin e saj. Më tej ministri theksoi se me investimet në Klinikën e Onkologjisë, tashmë kapacitetet e shtretërve janë dyfishuar, hapësirat janë riorganizuar dhe modernizuar, duke ofruar kushte shumë më të mira për pacientët.

TRAGJIKOMEDIA NË TRI AKTE!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

1. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese: Kosova, që nga zgjedhjet e 9 shkurtit 2025 është në fazën e hibernacionit (po mbijeton duke i hëngër rezervat, si ariu polar). Tash, me një pozitë bllokuese, antishtet dhe antikombëtare thuaja është në koma apo vdekje klinike. Opozita, e lodhur dhe aspak bashkëpunuese vetëm sa po e përshpejton shembjen e shtetit. Me një presidente që më shumë bredhë rrugëve të botës se që është në Kosovë, të shndërruar në zhagmbajtëse të deputetit Kurthi që, sikur dikur Cezari në Romë i ka uzurpuar të gjitha postet, është e pamundur të shpresojmë se do ta shohim një dritë në fund të tunelit e lëre më të jetojmë me dinjitet, qoftë edhe minimal. Tash, mbi supet tona të dërrmuara e kemi edhe një, deri te vendimi i GJK-së, mendermethënë kryetar Kuvendi. Budallai nuk paraqet rrezik nëse e luan rolin e të mençurit, deri në çastin kur beson se vërtetë është i mençur, disi si Dimal Basha që e shpalli Kuvendin si të formuar ndonëse ishte në Kundërshtim të plotë me Kushtetutën e Kosovës. Do të ishte qesharake po të mos ishte e shëmtuar takimi i tij me “homologë”, në cilësinë e kryetarit, ndonëse Kuvendi nuk ishte themeluar në pajtim me ligjin, Rregulloren, praktikën e deritashme dhe Kushtetutën. Si një antiUÇK i certifikuar me një “studim shkencorë” ky i pafytyrë mori guximin të shkojë (ilegalisht) te Varret e Dëshmorëve në Prekaz, te Varri i Abetares dhe Kuptimit të Luftës për Liri - te Bacë Adem Demaçi dhe te ish-presidenti Ibrahim Rugova. Për një atdhetar, ish të burgosur politik dhe luftëtarë të UÇK-së nuk mund të ketë fyerje më të madhe se kjo vizitë poshtëruese dhe blasfemike. Unë kam përgëzuar ata që e votuan vetëm për faktin se u çbllokua procesi dhe nuk kam pasur dijeni për “studimin shkencor” kundër UÇK-së i cili po përpiqet të distancohet (pasi u zgjodh kryetar i Kuvendit), si djalli nga temjani apo kryqi. Tash, pas vendimit të fundit të Gjykatës Kushtetuese, për ata që punojnë dhe besojnë në shtet ligjor rruga

drejtë formimit të Kuvendit të Kosovës është e qartë, duhet të votohet propozimi i grupit më të madh parlamentar i serbëve të Kosovës për nënkryetar të Kuvendit. Kështu është dashur të veprohet që në seancën e parë konstituive. Kështu është vepruar në të gjitha legjislaturat e mëparshme. Në vitin 2021 ishte votuar Sllavko Simiqi për nënkryetar edhe me votat e LVV-së dhe askush nuk e cilësuar këtë votim si tradhti. As sot nuk duhet të përdoret ky cilësim, nga askush dhe ndaj askujt. Sot është i njëjti kandidat, i njëjtit subjekt politik vetëm se është 5 vjet më i moshuar. Madje, nëse kemi parasysh bashkëpunimin e LVV-së me LS-ja e përmes sekseres mercenare, Mimoza Kusari, gjatë mandatit të fundit për çështje shumë të ndjeshme kombëtare dhe politike, LVV-ja është dashur që me aklamacion ta votojë Sllavko Simiqin. Sikur edhe “presidentja e rrugëve të botës” që, me votat bujare të LS-së u bë presidente. Lufta kundër LS-së është e shpikur dhe e shpifur, është sajësë që keqpërdoret në luftë për pushtet, nuk ka lidhje me patriotizëm. Më thoni çfarë patriotësh qenkan Hekuran Murati, Xhelal Sfeqla, Cen Bageri, Dejona Mihalidis, Dimal Basha, Elbert Krasniqi, i biri i Ali Milicit dhe të tjerë që vetëm me këtë “patriotizëm” kanë ulur prapancat në karrige e që, në rrethana normale nuk do të ndodhte asnjëherë. Më thoni se çka ka folur më keq dhe më zi për luftën dhe UÇK - në Sllavko Simiqi, se që e kanë bërë Hekuran Murati, Donika Shvarc, Nëna Mihalidis dhe Dimal Basha, midis shumë të tillëve të LVV-së! Është momenti i fundit që anija thuaja e fundosur në injorancën dhe patriotizmin e rremë, e quajtur Kosovë të nxirret nga bataku i rërës së gjallë ku e kanë futur arrivistët karrieristë, jopunëtorët dhe njerëzit e këqinjë! Nëse e duan vendin, ligjin dhe rregullin duhet ta zbatojnë vendimin e Gjykatës Kushtetuese, të gjithë, pa dallim, pozitë dhe opozitë! Aktualisht pozitës i duhet anarkia dhe shthurja e shtetit, opozitës jo. Nëse pozita nuk është e gatshme ta zbatojë këtë vendim, opozita

duhet ta zbatojë 100 për qind, edhe nëse humbë pak vota. Në planin afatgjatë askujt nuk i duhen votat jokushtetuese, votat e mbështetura në patriotizëm folklorik dhe armiq të sajuar, të brendshëm dhe të jashtëm. Nëse opozita i nënshtrohet një pozite shkatërruese e që nuk ka bërë asgjë për lirinë dhe shtetin e Kosovës le të shkrihet në LVV, si mendermethënë “Lista Guxo”. Pa themelim të Kuvendit nuk mund të ketë zgjedhje të reja të përgjithshme, Gjykata Kushtetuese nuk ka autoritet dhe mandat ligjor ta bëjë këtë, në asnjë rrethanë, pa themelimin e Kuvendit.

2. Lasgush Poradeci dhe Albin Kurthi: Lasgush Poradeci ishte, besoj njëri ndër intelektualët më të zotë dhe më të kompletuar shqiptar i të gjitha kohërave. Gjithashtu, ishte një patriot i bindur dhe i vendosur për bashkim kombëtar. Asnjëherë nuk ngrinte doli pa thënë: “mos qoftë kjo gota e fundit pa u bashkuar me Kosovën ..”. Ishte disident i bindur kundër diktaturës komuniste në Shqipëri prandaj jetoi në varfëri të madhe dhe i përbuzur deri në masën sa që e konsideronin të çmendur. Megjithatë, duke e çmuar aftësinë e tij si shkrimtar, autoritetet partiake të regjimit kërkuan nga ai të shkruajë një artikull afirmativ për një kooperativë bujqësore. Pasi u mbështet për muri e dërgoi shkrimin për të cilin partia reagoi ashpër duke i thënë se: “nuk na dërgove shkrim por m.t na dërgove..”. Përgjigja e gjeniut Lasgush Poradeci ishte se “m.t kërkuat, m.t ju dërgova..”. Albin Kurthi nuk është intelektual e as patriot i kalibrit të Lasgush Poradeci. Në opozitë ishte për bashkim kombëtar, tash thotë se Kushtetuta e Kosovës nuk ia lejon këtë ndonëse askush si ai nuk e ka dhunuar dhe shkërdhyer Kushtetutën. Me kërkesën e Hristijan Mickovskit, në mënyrë kriminale ndërhyri te faktori politik i shqiptarëve në Maqedoni të Veriut për ta eliminuar nga skena politike krahun e luftës çlirimtare dhe Ali Ahmetin, sikur që bëri edhe në

Kosovë. Fillimisht u angazhua personalisht, në Shkup dhe Prishtinë pastaj e përdorte Liburn Aliun. Tash, pasi Luburni u eutanazua (vdekje e asistuar) nga LVV-ja, për zgjedhjet lokale të 19 tetorit në Maqedoni të Veriut, si ndihmë dhe pykë, Kurthi e dërgoi, pas akademikut Agim Bahtiri, mbase intelektualin më të zgjuar dhe më të fuqishëm që e ka sot LVV-ja, Hysen Durmishin, i njohur me emrin artistik si Cen Bageri. Fjalimi i tij ishte ndihmë e jashtëzakonshme kundër unitetit shqiptar në Maqedoni, për llaskucët që flasin shqip e mendojnë turqisht që po kontribuojnë shumë për realizimin e “Botës Serbe” të Hristijan Mickovskit dhe nënkryetarit serb nga Partia Demokratike e Serbëve të Maqedonisë së Veriut, ndryshe familjar i ngushtë i Millan Radojiçiqit që botërisht ka kërkuar çnjojhe e Kosovës nga Maqedonia. Ditë më parë, partizani i madh i LVV-së dhe Albin Kurthi, Abdylhaqim - Kim Mehmeti, kërkoi nga dishepulli i tij t'i kthejë “shqiptarët” e Hristijan Mickovskit në “rrugë të Zotit” pasi vet Kurthi i paska futur në këto paudhë kombëtare. Si përgjigje Kurthi ua dërgojë Hysen Durmishin - Cen Bagerin që, katërcipërisht e vërteton se: “historia e vërtetë, nëse përsëritet si e shtrembëruar - sajuar, përfundon si farsë..”. Sikur historia e shkrimit të Lasgush Poradecit për kooperativat bujqësore në Shqipëri. Nëse kërkoni m.t, m.t do të keni, nëse kërkoni Hysen Durmish, të njëjtin do ta keni!

3. Beretat e Kuqe: Qeveria e Malit të Zi i dorëzoi një Notë Proteste Ambasadës së Kosovës në Podgoricë shkaku se, sipas tyre paska pasur të shtëna me armë zjarri nga Kosova në kufirin midis dy shteteve. Fatmirësisht ky incident serioz u heshtë dhe nuk ka ndonjë informatë zyrtare, as për shkaqet e as për pasojat. Mirëpo, dashakeqësit dhe llafet e qarshisë thonë se ky nuk ka qenë rast i izoluar por i paramenduar dhe planifikuar mirë. Pasi dështuan përpjekjet e përditshme politike të LVV-së e që instrument e përdorë

pushtetin aktual, për kthimin e mbi 8000 km të territorit që përmes Demarkacionit, padrejtësisht i janë dhënë Malit të Zi, Nëna e Madhe e LVV-së ka propozuar që këto territore të kthehen forcërisht. Për këtë aksion me emër të koduar “Pordha e Madhe” i ka kombinuar të gjitha gjinitë e forcave të armatosura në krye komandanten e Përgjithshme, brigadieren e Kurthit, Vojsa Osmani. Forcat e rregullta ushtarake u janë besuar luftëtarëve të shquar të luftës së fundit, Lal Cullës dhe Cen Bagerit. Dashakëqinjtë për ta thonë se kanë qenë dezertorë të ndyrë prandaj mrekullisht përshtaten në “strategjinë ushtarake” të zonjës Mihalidis, e para e së radhës së Beretave të Kuqe dhe Faqes së Zezë. Njësitë paramilitare i janë besuar Hekuran Muratit, këtij rrenci dhe urryesi të luftës çlirimtare. Oficer për moral kundër UÇK-së, në mënyrë aklamative është emëruar Dimal Basha. Përgjegjës për operacione speciale në tokë e sidomos në ujë, me bazë në lumin Moraça është caktuar admiral i flotës detare, Agim Bahtiri. E ka dëshmuar këtë në luftë me Goran Rakiqin në lumin Ibër. Për harta topografike është caktuar Shpejtim Bulliqi, e njeh terrenin që duhet rikthyer në malet e Çakorrit të Koresë së Veriut. Ky është vetëm fillimi, pas Çakorrit vjen Manastiri i Deçanit, deri te Molla e Kuqe ku “pordhaxhinjtë” e bashkimit kombëtarë do hanë dardha kak- içe.

Kur shpërfilltet Seneka: Seneka e kishte një thënie që shpërfilltet nga budallenjtë e respektohet nga të urtët se: “kur të shkoni për të marrë hak, hapni dy varre...”. Përkthyer në shqip: “kur të shkoni për të rikthyer territoret, në emër të bashkimit të rremë kombëtar, do ta fitoni Marrëveshjen e Brukselit me aneksin e Ohrit..”. O Albin “Baba”. Edhe ne që jemi për Barcelonën e shpërfillëm Senekën, shkuam me marrë hak kundër PSG-së, u ndamë me miza bythëve. Shpresojmë në më të mirën, megjithatë!

ZKA-JA EVIDENTON MANGËSI NË PROJEKTIN “NDËRTIMI I SHESHIT SË BASHKU ME NËNKALIMET DHE PARKINGUN NËNTOKËSOR NË QYTETIN E MALISHEVËS”

PRISHTINË, 2 TETOR - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka publikuar raportin e auditimit të performancës “Efikasiteti në planifikimin dhe menaxhimin e projektit ‘Ndërtimi i sheshit së bashku me nënkalimet dhe parkingun nëntokësor në qytetin e Malishevës’” për periudhën 2022 - mars 2025. Auditimi ka vlerësuar efikasitetin e komunës në planifikimin dhe menaxhimin e këtij projekti si dhe ndikimin i tij në zhvillimin urban dhe jetën e qytetarëve. Rezultatet e auditimit tregojnë se komuna e Malishevës nuk ka qenë efikase në planifikimin dhe menaxhimin e projektit të kontraktuar në vlerë 8.28 milionë euro. Kontrata e këtij Projekti ishte nënshkruar me mbështetje buxhetore prej 2.03 milionë eurosh dhe kishte filluar pa planifikim të hollësishëm, duke u përcjellë më pas me rritje të kostove.

Përveç kontratës bazë, komuna e Malishevës kishte lidhur edhe anekskontratë në vlerë mbi 800 mijë euro si dhe kostot të pritshme deri në përfundim të projektit janë rreth 500 mijë euro. Përveç kësaj, janë ridestinuuar rreth 520 mijë euro nga projekte të tjera për ta mundur ndërtimin e këtij projekti. Në procedurat e prokurimit për kontraktimin e kompanisë projektuese ka pasur mungesë të transparencës dhe trajtim jo të barabartë. Po ashtu, janë evidentuar mospërputhje në mes çmimeve të vlerësuara dhe atyre të kontraktuara te 226 pozicione nga gjithsej 802, ose 28 % e tyre, ku çmimi i kontraktuar ishte deri në 1 600 % (në dy pozicione) më i lartë se ai i parashikuar. Kishte edhe dallime të theksuara mes sasive të parashikuara në projekt, të kontraktuara dhe atyre të realizuara në praktikë. Këto dallime janë vërejtur në 302



pozicione nga 802 sa kanë qenë gjithsej apo 37 % e pozicioneve. Kontrata nuk ka pasur mbikëqyrje profesionale, duke bërë që sasia dhe cilësia e materialeve të pranura të jetë e paqartë. Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së menaxhimit të kontratës për hartimin e projektit, si dhe mungesës së organit mbikëqyrës të pavarur gjatë realizimit të

kontratës gjë që ka rezultuar në menaxhim dhe mbikëqyrje të dobët të saj. Mungesa e masave të nevojshme nga komuna për menaxhimin dhe mbikëqyrjen adekuate të cilësisë së punimeve ka ndikuar që cilësia dhe siguria e projektit të rrezikohet. Gjithashtu, auditimi ka vënë në pah se projekti nuk ishte i bazuar në një Plan Zhvillimor Urban, nuk ka pasur

konsultime me qytetarët dhe palët e interesit, ndërsa lejet për ndërtim janë siguruar pas fillimit të punimeve. Ndonëse projekti synon të kontribuojë në urbanizimin e qytetit, gjatë realizimit ka shkaktuar vështirësi në qarkullim e qytetarëve, zhvillimin e aktiviteteve të tyre dhe bizneseve përreth. Lidhur me këtë auditim, auditorja e përgjithshme, Vlora Spanca, theksoi se mangësitë në planifikim, buxhetim dhe mbikëqyrje kanë ndikuar në efikasitetin, cilësinë dhe sigurinë e projektit “Ndërtimi i sheshit së bashku me nënkalime dhe parkingun nëntokësor në qytetin e Malishevës”. Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka dhënë nëntë rekomandime për komunën e Malishevës me qëllim që të përmirësohet procesi i planifikimit dhe menaxhimit të projekteve kapitale.

RRITET NORMA E INTERESIT, BIE NUMRI I DHËNIES SË KREDIVE NË KOSOVË, SHKAK INFLACIONI DHE MOSKRIJIMI I INSTITUCIONEVE

PRISHTINË, 2 TETOR - Normat e interesit në bankat komerciale në Kosovë janë rritur muajin e fundit dhe askush nuk ka dhënë shpjegim për këtë. Kështu është rënduar edhe më shumë buxheti i kosovarëve, ndërsa është rënë numri i dhënies së kredive. Disa banka ofrojnë kredi me normë interesi mbi 7 %, ndërsa për bizneset norma është bërë 10 %. Ish-guvernatori i BQK-së, Fehmi Mehmeti, që tashmë udhëheq Institutin Hulumtues për Ekonomi dhe Financa, përmend disa faktorë. Në emisionin “Radar” në “Radio Dukagjini” ai tha se një vendim i BQK-së ka ndikuar, pastaj inflacioni dhe situata politike me moskrijimin e institucioneve. “Në rend të parë vendimi i BQK-së. BQK-ja dimë që nuk cakton norma të interesit direkt, mirëpo përmes



rregulloreve të ndryshme, rezervave të detyrueshme dhe kërkesës për kapital, kjo ndikon në koston e bankave. Deri më tani në gusht të këtij viti kur u rrit norma e interesit mjaftueshmëria ka qenë 8 në raport me klasën e parë dhe 12 në total. Nga gushti i këtij viti BQK-ja

e ka rritur këtë mjaftueshmëri të kapitalit nga 10 dhe 14 % në këtë rast, pra banka duhet të mbajë më shumë kapital rezervë për çdo kredi që jep. Kjo d.m.th që kanë më pak hapësirë për dhënien e kredive të reja. Kosto e kapitalit rritet sepse aksionarët dhe bankat duhet të investojnë

shumë para në Kosovë për t'i mbrojtur normat e reja. Normat e interesit rriten për ta kompensuar këtë bllokun e kapitalit të bankave dhe këtë kosto këta zakonisht e transferojnë te klientët e tyre”, tha ai. Faktor tjetër ai ka përmendur edhe inflacionin. “Faktor tjetër është inflacioni. Bankat i rrisin normat për ta ulur fuqinë blerëse dhe për ta ulur rrezikun që kursimet dhe kreditë ta humbin vlerë. Kur inflacioni rritet, kursimet në banka kanë vlerë më pak, qytetarët kërkojnë kthim më të lartë, e bankat për ta mbrojtur veten rrisin normat e interesit të kredive, në të njëjtën kohë inflacioni i lartë e shton rrezikun e mospagesës nga qytetarët për shkak të shpenzimeve më të larta që kanë”, tha ai.

Banka Notërore parashikon që Kosova të ketë rritje ekonomike prej 3.8 %. E për këtë Mehmeti thotë se janë dy faktorë. “Dy faktorë botërorë të këtij parashikimi janë pasiguria ekonomike dhe vonesa në ndërtimin e institucioneve që ndikon negativisht në investime në zbatimin e agjendës së reformave ekonomike. Kërkesa ime është që sa më shpejt të themelohen institucionet në Kosovë, pastaj të fillojmë të merremi me problemet e shumta që i ka Kosova”, tha Mehmeti në Radio Dukagjini. Megjithatë, ai shpreh optimizëm do të ulen normat e interesit, por thotë se BQK-ja duhet të ketë kujdes në rregulloret që i ka parasysh, ngase fokus duhet ta ketë stabilitetin financiar.

AKA organizon konferencën e tretë ndërkombëtare për arsimin e lartë

PRISHTINË, 1 TETOR - U mbajt konferenca e tretë ndërkombëtare vjetore për arsimin e lartë, e organizuar nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA), me temën: “Arsimi i lartë i ndërkombëtarizuar: tejkalimi i kufijve për të bashkuar njerëzit”. Më shumë se 160 pjesëmarrës nga vende të ndryshme evropiane, nga rajoni, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Kosova, morën pjesë në panele të ndara, ku u diskutua mbi përparësitë dhe sfidat e ndërkombëtarizimit të arsimit të

lartë. Temat e trajtuara përfshinë: rolin e ENQA dhe EQAR në ndërtimin e urave mes institucioneve të arsimit të lartë përmes zbatimit të standardeve evropiane të cilësisë; edukimin transnacional; ndikimin e ndërkombëtarizimit në sigurimin e cilësisë dhe në sistemet kombëtare të edukimit; bashkëpunimin përtej kufijve; si dhe rolin e diasporës në këtë proces. Në konferencë morën pjesë me paraqitjet e tyre edhe Doris Herrmann, nënkryetare e Bordit të ENQA, Peter Levente Lakatos,

anëtar i Bordit të ENQA, si dhe Aleksandar Susnjar, drejtor i EQAR. Gjatë hapjes së konferencës, AKA ndau edhe certifikata të cilësisë për institucionet që janë dalluar në fushën e ndërkombëtarizimit dhe profilizimit. Fitues të certifikatave ishin Fakulteti i Edukimit i Universitetit të Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë i Universitetit të Prishtinës, Universiteti i Pejës, Universiteti i Prizrenit dhe Kolegji “Tempulli”. Konferenca u mbështet nga projekti SHER, i cili financohet nga Agjencia ADA e Austrisë.



GUVERNATORI ISMAILI RIKONFIRMON PËRKUSHTIMIN E BQK-së PËR INTEGRIMIN EVROPIAN

PRISHTINË, 2 TETOR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, mori pjesë në takimin vjetor të Forumit të Iniciativës së Vjenës (Vienna Initiative), i cili u mbajt më 29-30 shtator në Bruksel, organizuar nga Komisioni Evropian, me pjesëmarrjen e komisionares së BE-së, Maria Luis Albuquerque. Forumi mbledhi së bashku guvernatorët e bankave qendrore, rregullatorët, institucionet financiare ndërkombëtare, bankat dhe përfaqësues të sektorit më të gjerë financiar për të diskutuar lidhur me Unionin e Kursimeve dhe Investimeve si dhe mundësitë e integritit të Tregjeve të Kapitalit në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore (CESEE).

Takimi u drejtua nga Boris Vujcic, guvernator i Bankës Kombëtare të Kroacisë dhe kryesues i Komitetit Drejtues të Iniciativës së Vjenës. Pjesëmarrës të nivelit të lartë ishin gjithashtu John Berrigan, drejtor i përgjithshëm i DG FISMA dhe Gert Jan Koopman, drejtor i përgjithshëm i DG

ENEST, së bashku me guvernatorë dhe zëvendësguvernatorë nga bankat qendrore të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore si dhe përfaqësues të institucioneve financiare ndërkombëtare. Guvernatori i BQK-së riafirmoi përkushtimin e saj të fortë për avancimin e integritit në tregun evropian, duke theksuar rëndësinë e reformave të vazhdueshme të infrastrukturës së tregut dhe rrugëtimin strategjik të Kosovës drejt anëtarësimit në Zonën Unike të Pagesave në Euro (SEPA).

Anëtarësimi në SEPA si prioritet për BQK-në përfaqëson jo vetëm modernizimin e sistemit të pagesave, por edhe një hap thelbësor drejt harmonizimit me standardet e BE-së dhe thellimin e integritit financiar dhe ekonomik evropian. Diskutimet gjatë forumit nënvizuan rëndësinë e një infrastrukture të qëndrueshme të tregut financiar të BE-së për mbështetjen e Unionit të Kursimeve dhe Investimeve. Në



këtë kontekst, BQK-ja angazhohet ta avancojë legjislacionin për ta zgjeruar qasjen në financim dhe për ta krijuar tregun e kapitalit krahas reformave që synojnë forcimin e sistemeve të pagesave, avancimin e praktikave mbikëqyrëse dhe rritjen e efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së ekosistemit financiar të Kosovës. Këto nisma synojnë rritjen e besimit të investitorëve për ta zgjeruar qasjen

në shërbime financiare dhe për ta mbështetur konkureshmërinë afatgjatë të ekonomisë. Në kuadër të Forumit, guvernatori Ismaili takoi dhe diskutoi me përfaqësues të lartë nga Komisioni Evropian, Banka Qendrore Evropiane (BQE), Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Banka Evropiane e Investimeve (BEI), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Banka Botërore (BB), si

dhe me guvernatorë të bankave qendrore të rajonit (CESEE). BQK-ja rikonfirmon përkushtimin e saj për forcimin e bashkëpunimit rajonal, përsheptimin e integritit financiar dhe avancimin e reformave, ku anëtarësimi në SEPA shërben si bazë e modernizimit dhe integritit financiar dhe si nxitës i rritjes së qëndrueshme ekonomike, me përfitime konkrete për qytetarët dhe bizneset e Kosovës.

DIASPORA E KOSOVËS SOLLI RRETH 928 MILIONË EURO PËR TETË MUAJT E PARË TË 2025-S

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 TETOR - Banka Qendrore e Kosovës ka paraqitur statistikën e bilancit të pagesave, remitancave, investimeve direkte etj. BQK-ja ka njoftuar se remitancat janë kategoria kryesore në kuadër të të ardhurave dytësore, vlera e të cilave deri në korrik 2025 shënoi 785.06 milionë euro, që paraqet rritje prej 31.27 milionë euro ose 4.15 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024. Ndërsa sipas vlerësimeve preliminare, remitancat për muajin gusht 2025 ishin rreth 143.4 milionë euro, duke arritur kështu vlerën 928.48 milionë euro (preliminare) për tetë muajt e parë të vitit 2025. Sipas këtyre statistikave, prurjet më të mëdha edhe gjatë muajit gusht kanë qenë përmes IFJB me 41.02 % përmes bankave



komerciale me 17.19 % dhe kanaleve të tjera me 41.79 %. Ndërkaq, BQK-ja ka dhënë statistika edhe lidhur me investimet direkte. “Investimet Direkte në Kosovë deri në fund të korrikut 2025 ishin 540.94 milionë euro që paraqet një rritje prej 24.24 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit kaluar, përdërisa investimet direkte jashtë Kosovës shënuan

vlerën 212.78 milionë euro”, thuhet në raport. Banka Qendrore e Kosovës ka njoftuar, po ashtu, lidhur me borxhin e jashtëm bruto. “Borxhi i jashtëm bruto - i cili përfshin borxhin publik dhe privat në fund të tremujorit të dytë 2025, arriti vlerën 4.43 miliardë euro, e cila paraqet rritje prej 218.19 milionë eurosh krahasuar me

tremujorin paraprak. Kontribuuesi kryesor i rritjes së borxhit të jashtëm në Kosovë ishte sektori privat për 133.13 milionë euro, ndërsa borxhi publik u rrit për 85.05 milionë”, bëhet e ditur në raport. Ndërkaq, sa i përket borxhit të sektorit publik në fund të tremujorit të dytë 2025 arriti vlerën 1.02 miliardë euro, duke marrë pjesë me 23.03 % në gjithsej borxhin e jashtëm. Pjesa më e madhe e borxhit publik përbëhet nga borxhi i jashtëm i qeverisë, i cili në fund të tremujorit të dytë 2025 ishte 857.81 milionë euro. BQK-ja ka paraqitur edhe të dhëna për borxhin e sektorit privat. “Borxhi i sektorit privat - të tremujorit të dytë 2025 - arriti vlerën 3.41 miliardë euro. Pjesëmarrësit në borxhin privat janë bankat komerciale 21.10 %, kompanitë në relacion të investimeve direkte 27.31 % dhe sektorët e tjerë 51.59 %”,

thuhet në raport. Sa i përket bilancit tregtar në mallra, deri në fund korrikut 2025 shënoi deficit në vlerë 3.19 miliardë euro, që është për 19.03 % më i lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Eksporti për këtë periudhë shënoi vlerën 528.27 milionë euro e që paraqet rënie prej 1.71 %, ndërsa importi i mallrave shënoi rritje prej 15.57 % duke arritur vlerën 3.72 miliardë euro. Ndërsa sa i përket pozicionit të investimeve ndërkombëtare, në tremujorin e dytë 2025 u karakterizua me rritjen e vlerës së aseteve ndërkombëtare për 280.91 milionë euro dhe detyrimeve ndërkombëtare për 468.12 milionë euro. Vlera e akumuluar e aseteve ndërkombëtare në fund të qershorit 2025 shënoi 8.41 miliardë euro, ndërsa vlera e detyrimeve 10.96 miliardë euro.

Çmimi i arit arrin nivelin më të lartë në histori

PRISHTINË, 2 TETOR - Çmimi i arit të enjten arriti nivele rekord pas bllokimit të parë të punës së qeverisë amerikane në pothuajse shtatë vjet për shkak të mosmarrëveshjeve për buxhetin. Kjo situatë krijon pasiguri, veçanërisht para takimit të ardhshëm të Rezervës Federale

(Fed). Nuk dihet sa do të zgjasë bllokimi, që në të kaluarën ka qenë edhe më i gjatë, raporton cnbc. Në këtë klimë pasigurie, asetet me rrezik humbën vlerën, ndërsa ari, i konsideruar si strehë e sigurt në kohë krizash ekonomike apo politike, vazhdoi të rritet dhe

arriti çmimin rekord prej rreth 3 900 dollarësh për “ounce”. Analistët mendojnë se çmimi i arit mund të arrijë edhe 4 000 dollarë ose më shumë, duke u përkrahur nga faktorë si konflikte politike, tarifatat dhe kërkesa në rritje nga investitorët dhe bankat qendrore.



HISTORIANI GJERMAN PËRDOR AI PËR TË ZBULUAR FOTON MË FAMËKEQE TË HOLOKAUSTIT



Një nga imazhet më të ftohta dhe tronditëse të Holokaustit, ku një ushtar nazist i veshur me uniformë dhe syze drejton armën drejt kokës së një burri hebre që gjunjëzohet para një grope të mbushur me trupa, ka marrë një dimension të ri pas gjetjeve më të fundit të një historiani gjerman. Prej vitesh, fotoja njihej gabimisht si “Hebreu i fundit në Vinica” (The Last Jew in Vinnitsa) dhe ishte shoqëruar me mister mbi vendin, datën dhe identitetin e autorëve të krimit. Tashmë, pas një pune shumëvjeçare kërkimore të kombinuar me përdorimin e inteligjencës artificiale, historiani Jürgen Matthäus thotë se ka arritur të identifikojë personin që shfaqet në rol vrasësi në atë moment fatal.

Zbulimi i bërë përmes arkivave dhe inteligjencës artificiale

Sipas studimit të tij të botuar në revistën shkencore Zeitschrift für Geschichtswissenschaft, masakra është kryer më 28 korrik 1941, në

qytetin Berdychiv, rreth 150 kilometra në jugperëndim të Kievit. Atje, komandoja naziste Einsatzgruppe C kishte filluar aksionet për shfarosjen e hebrenjve dhe “partizanëve” pak ditë para vizitës së Adolf Hitlerit në front. Falë kombinimit të metodave tradicionale të hulumtimit historik, arkivave, dëshmimeve familjare dhe analizës së imazheve nga ekspertët e grupit investigativ Bellingcat, Matthäus arriti të identifikojë nazistin e armatosur në foto si Jakobus Onnen, një mësues gjerman i gjuhëve dhe gjimnastikës, lindur në vitin 1906 pranë kufirit me Holandën.

Si ndihmoi inteligjenca artificiale

Një lexues, i ndikuar nga publikimi i parë i kërkimeve të Matthäus, kishte kontaktuar duke treguar se, sipas letrave dhe dokumenteve familjare, i afërmi i gruas së tij mund të ishte njeriu në fotografi. Megjithëse shumë letra nga fronti lindor ishin shkatërruar në vitet

’90, familja ruante ende foto të Onnenit. Këto u përdorën përmes një krahasimi të detajuar me imazhin famëkeq, duke përdorur teknologji të inteligjencës artificiale për njohjen e fytyrës. Ekspertët e IA-së theksuan se për imazhe historike nuk është e mundur të arrihet një përputhje absolute si në analizat forenzike moderne, por ngjashmëria ishte mjaft e lartë dhe, e kombinuar me prova të tjera dokumentare, mjaftonte për ta bërë identifikimin publik.

Kush ishte Jakobus Onnen?

Onnen i përkiste një familjeje të arsimuar dhe në rini kishte interes për udhëtime e studime gjuhësore. Ai u anëtarësua në Partinë Naziste përpara ardhjes në pushtet të Hitlerit në vitin 1933 dhe, si shumë bashkëkohës të tij, u përfshi në njësitë e shfarosjes gjatë pushtimit të Bashkimit Sovjetik. Ai mbeti një ushtar i thjeshtë, pa u promovuar ndonjëherë në gradë të larta, dhe u vra në front në gusht

të vitit 1943. “Pjesëmarrja në masakra të tilla nuk të siguronte karrierë apo shpërblime. Ishte diçka e konsideruar si normale në ato njësi të vrasjes”, shpjegon Matthäus. Historiani shpreh keqardhje që letrat origjinale të Onnen nga fronti u shkatërruan, pasi ato mund të kishin dhënë më shumë informacion mbi motivet dhe bindjet e tij. Megjithatë, një i afërm që i kishte lexuar në atë kohë i përshkroi si “banale”, duke treguar mungesën e reflektimit mbi krimet.

Një foto simbol i Holokaustit në lindje

Fotografia e masakrës në Berdychiv, sipas Matthäus, është një nga dëshmitë më të drejtpërdrejta të krimeve të Holokaustit. Ai thekson se imazhi është po aq i rëndësishëm sa pamja ikonike e portës së kampit Auschwitz, pasi tregon ballë për ballë momentin mes viktimës dhe vrasësit. Në Berdychiv, ku jetonin rreth 20

mijë hebrenj para pushtimit nazist, në vitin 1944 kishin mbetur gjallë vetëm 15, sipas raportimeve të Der Spiegel. Fotografi të tilla, shpesh të marra nga vetë ushtarët gjermanë si “trofe”, tregojnë brutalitetin e hapur të masakrave dhe rrëzojnë mitin se shoqëria gjermane nuk ishte në dijeni të genocidit.

Puna për të identifikuar viktimën

Matthäus ka nisur tashmë një fazë tjetër të kërkimit: identifikimin e viktimës së gjunjëzuar në foto. Ai po bashkëpunon me studiuesin ukrainas Andrii Mahaletskyi dhe po shfrytëzon arkivat sovjetike për të zbuluar emrin e tij. Edhe në këtë rast, inteligjenca artificiale mund të ndihmojë, nëse gjenden imazhe të krahasueshme nga komunitetet e shkatërruara hebreje në atë zonë. “Pjesa më e madhe e më shumë se një milion viktimave në territoret e pushtuara të Bashkimit Sovjetik mbeten të panjohura, ashtu siç donin edhe vetë vrasësit,” shprehet Matthäus.

PLANI I TRUMP PËR ARMËPUSHIM NË GAZA, PËRÇARJE TË THELLA NË DY GRUPE BRENDAMAS

Pas prezantimit të planit amerikan për armëpushim nga presidenti Donald Trump dhe kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu, fraksionet kryesore palestineze po përpiqen të formulojnë një përgjigje të përbashkët. Megjithatë, kjo është një sfidë e madhe për shkak të përçarjeve të brendshme në dy grupet kryesore: Hamas, i cili është i përfshirë drejtpërdrejt në konfliktin në Gaza dhe Fatah, që ka kontrollin në Bregun Perëndimor. Kryeministri i Katarit, sheiku Mohammed bin Abdulrahman Al Thani, ka dhënë sinjalet e para se plani amerikan përmbush disa nga objektivat kryesore të ndërmjetësve ndërkombëtarë, duke përfshirë ndalimin e masakrave dhe zhvendosjeve

masive të palestinezëve. Megjithatë, mbeten pika të diskutueshme, veçanërisht lidhur me afatet kohore dhe shkallën e tërheqjes së forcave izraelite nga Gaza, si dhe përbërjen dhe natyrën e administratës së ardhshme palestineze. Në brendësi të Hamasit, përçarjet janë të thella. Një pjesë e këtij grupi, e njohur si më radikalja, refuzon planin, duke e konsideruar atë një akt dorëzimi dhe poshtërimi për kauzën palestineze. Megjithatë, shumica e udhëheqjes duket se është e gatshme ta pranojë planin me kushte të caktuara, për të shmangur fajësinë për vazhdimin e konfliktit, por duke refuzuar klauzolat që mund të cenojnë të drejtat kombëtare palestineze. Përmes ndërmjetësve si Katari,

Egipti dhe Turqia, Hamas kërkon ndryshime specifike në klauzolën e çarmatimit, duke bërë dallimin midis armëve mbrojtëse dhe sulmuese, si dhe garanci për një tërheqje të plotë dhe të shpejtë të Izraelit nga Gaza. Ata gjithashtu kërkojnë që administrata e ardhshme të jetë plotësisht në duart e palestinezëve dhe jo nën ndikimin e Autoritetit Nacional Palestinez (ANP). Nga ana tjetër, edhe brenda Fatahut ka tensione të dukshme. Presidenti palestinez Mahmoud Abbas (Abu Mazen) mbështet përpjekjet e ndërmjetësve arabë dhe qasjen amerikane, por brenda partisë së tij ka zëra kritikë, si ai i Abbas Zakit, i cili e cilëson planin si një “dokument dorëzimi” që nuk reflekton aspiratat reale të popullit palestinez. Një burim nga

Ramallahu thekson se Fatahu është e ndarë mes atyre që mbështesin planin, përfshirë Abbas dhe zëvendësin e tij Hussein al-Sheikh, dhe atyre që janë kundër tij. Ndërkohë, brenda Hamasit diskutimet vazhdojnë intensivisht, dhe pritet që përgjigja e parë për planin të dalë brenda disa ditësh. Kreu i Shërbimit të Informacionit Shtetëror të Egjiptit, Diaa Rashwan, shpreh optimizëm se Hamas do ta pranojë planin me disa rezervë, duke hapur rrugë për armëpushim. Në këtë sfond diplomatik të ndërlikuar, Katari ka arritur një marrëveshje të veçantë me SHBA-në, ku Shtetet e Bashkuara garantojnë mbrojtjen e Katarit në rast sulmesh ndaj territorit të tij, duke e konsideruar një kërcënim

për sigurinë kombëtare amerikane. Katari është një aleat strategjik i SHBA-së në Gjirin Persik, mik personal i Trump dhe vendi ku ndodhet baza kryesore ushtarake amerikane në rajon, al-Udeid. Roli i Katarit si ndërmjetës në këtë konflikt dhe marrëveshja e sigurisë me SHBA-në i japin atij një pozicion unik, madje më të fortë sesa vetë Izraeli, i cili nuk ka një marrëveshje të tillë sigurie me amerikanët. Sulmi izraelit në Doha më 9 shtator nuk arriti të eliminojë udhëheqjen e Hamasit jashtë Gazës, dhe në mënyrë të papritur forcoi pozicionin e Katarit në rajon dhe marrëdhëniet e tij me SHBA-në, duke krijuar një dinamikë të re që mund të ndikojë në zgjidhjen e konfliktit dhe në përpjekjet për armëpushim.




Orban: Liderët e BE-së duan luftë me Rusinë!

Udhëheqja e BE-së duket se është e vendosur ta shtyjë bllokun në një luftë me Rusinë, tha të enjten kryeministri hungarez Viktor Orban. Në një postim në “X”, kritikuesi i hershëm i politikës perëndimore ndaj Ukrainës paralajmëroi se “propozime të hapura pro-luftës janë në tryezë”, duke cituar diskutimet në një samit informal të liderëve të BE-së në Kopenhagen këtë

javë. “Ata duan t’ia dorëzojnë fondet e BE-së Ukrainës. Ata po përpiqen të përshpejtojnë pranimin e Ukrainës me të gjitha llojet e trukeve ligjore. Ata duan të financojnë dërgesat e armëve. Të gjitha këto propozime tregojnë qartë se brukselianët duan të shkojnë në luftë”, shkroi Orban, duke u zotuar se Budapesti do t’i kundërshtonte masa të tilla.

Takimi i Kopenhagenit u thirr pas një sërë pamjesh të dronëve të pidentifikuar në të gjithë Evropën. Kryeministrja daneze Mette Frederiksen tha se qeveria e saj nuk mund të përcaktonte origjinën e avionit, por pretendoi se “të paktën mund të konkludojmë se ekziston kryesisht një vend që përbën kërcënim për sigurinë e Evropës, dhe ai është Rusia”.





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Historike: Bashkimi kualifikohet në FIBA Europe Cup

PRIZREN, 2 TETOR - Klubi i Basketbollit Bashkimi ka siguruar një vend në fazën e grupeve të FIBA Europe Cup pavarësisht humbjes që ka pësuar të mërkurën mbrëma. Prizrenasit janë kualifikuar si një nga tri skuadrat e njohura ndryshe si “humbës me fat”,

duke përfituar nga rregullorja e garës. Sipas FIBA-s, shtatë fitueseve të ndeshjeve kualifikuese të FIBA Europe Cup do t’u bashkohen edhe tri ekipe të tjera të zgjedhura si “lucky losers”, vende të cilat u takojnë skuadrave të cilat do

të pësojnë humbje me epërsi më të ulët. Kjo procedurë është bërë e nevojshme pasi Bursaspor, Elan Chalon dhe Patrioti Levice kanë avancuar në fazën e rregullt të Basketball Champions League, duke lënë hapësirë për plotësimin e

vendeve në FIBA Europe Cup. Ky është një sukses historik për Bashkimin si dhe Kosovën, pasi për herë të parë dy skuadra të Kosovës do të marrin pjesë në fazën e grupeve në FIBA Europe Cup, ku Trepça tashmë e kishte të siguruar vendin.



ADEMI: KOSOVËN E SHOH TË KUALIFIKUAR NË EURO 2028, FANELLA E KOMBËTARES KA BARRËN E GJAKUT DHE SAKRIFICËS

PRISHTINË, 2 TETOR - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka folur me emocione të thella në episodin e parë të “FFK Podcast”, duke treguar vizionin e tij për të ardhmen e futbollit të Kosovës, pritjet ndaj Kombëtares dhe mesazhin që qëndron pas fanellës “dardane”.

I pyetur se si e shih Kosovën në kualifikimet aktuale për Kampionatin Botëror dhe në projektet afatgjatë, Ademi ka thënë se objektivi realist është kualifikimi në Euro 2028, ndonëse fitorja ndaj Suedisë ka rritur ambiciet e tifozëve. “Tani sigurisht që po, s’ka presion. Ky është realiteti siç e shoh unë. Ka ekspertë që e kanë parë Kosovën



që duhej të ishte në Evropian qysh në herën e parë ose në kualifikimet për Botërorin Rusia 2018. Kjo është mirë sepse tregon se sa emocion ka krijuar Kosova dhe Kombëtarja jonë. Është një

lidhje emocionale. Dashuria është aq e madhe dhe duan ta shohin të parën. Dashuria e madhe sjell edhe zhgënjim, por kjo është bukuria e futbollit”, ka thënë Ademi.

Ai ka thënë se kualifikimi i Kosovës në një kampionat të madh është çështje kohe dhe se aspirata e tij kryesore është Euro 2028. “Po, e mendoj që 2028 Kosovën e gjen të kualifikuar. Nuk është premtim, por është mendim dhe aspiratë. Sepse në futboll nuk i dihet kurrë, sidomos në rezultate”, ka thënë ai. Më tutje, Ademi ka folur për domethënien e fanellës së Kombëtares së Kosovës, duke i dhënë një dimension historik dhe atdhetar. “Fanella e Kosovës, çdo vije dhe çdo katror që ka, ka brenda një të zhdukur, një të vvarë, një dëshmor dhe një viktimë. Është fanellë e shndërruar nga uniforma e UÇK-së në uniformë të lirisë. Kjo e bën

popullin krenar. Prandaj, duhet pasur shumë kujdes kur kritikohet kjo fanellë, sepse është më shumë se futboll”, ka thënë Ademi.

Në fund, presidenti i FFK-së ka thënë se karrierën e shih të lidhur vetëm me futbollin dhe se synimi i tij është të lërë pas një trashëgimi të fortë. “Jam aktivist prej ditëve të para, nga ilegalja e deri në luftë. Asnjëherë s’e kam potencuar këtë, por jam përkushtuar për futboll. Karriera ime mbaron këtu. Dua të lë një ekip fantastik, me bagazh, me dije brenda e rreth Federatës. Një kombëtare prestigjioze që do të ketë emër në Evropë. Kjo është dëshira ime më e madhe dhe besoj që është dëshira e secilit”, ka thënë presidenti Ademi.

MBAHET AKTIVITET I VEÇANTË SPORTIV NË PRISHTINË

PRISHTINË, 2 TETOR - Në ambientet e Shkollës Filllore dhe të Mesme të Ulët “Xhemajl Mustafa” në Prishtinë është organizuar një aktivitet i veçantë sportiv në kuadër të projektit “Move Up”, një iniciativë e mbështetur nga Bashkimi Evropian përmes programit ERASMUS dhe e zbatuar nga Federata e Futbollit të Kosovës (FFK).

Ky projekt ka për qëllim promovimin e përgjegjësisë sociale dhe përmirësimin e mirëqenies fizike e mendore të qytetarëve, veçanërisht të moshave të mesme dhe të treta. Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti sportiv është të ndihmohet në

parandalimin dhe menaxhimin e sëmundjeve kronike, si diabeti i tipit 2 dhe hipertensioni, duke nxitur një stil jete më aktiv dhe më të shëndetshëm.

Aktiviteti ka përfshirë tre lloje sportesh të përshtatura për këtë grupmoshë: futboll në ecje (Walking Football), basketboll në ecje (Walking Basketball) dhe Catchboll. “Këto sporte janë të dizajnuara që të jenë të sigurt, të lehta për t’u ndjekur dhe shumë të përshtatshme për pjesëmarrësit mbi moshën 40 vjeç (gra) dhe 50 vjeç (burra)”, ka njoftuar FFK-ja.

Sipas këtij njoftimi, të pranishëm në këtë aktivitet ishin pjesëmarrës



të shumtë nga komuniteti lokal e ish-sportistë të cilët me shumë

entuziazëm morën pjesë në lojërat e zhvilluara. “Atmosfera

ishte motivuese dhe përplot energji pozitive, duke dëshmuar edhe një herë rëndësinë që ka sporti në ndërtimin e një komuniteti më të shëndetshëm dhe më të bashkuar. Ky projekt do të vazhdojë nga dita e sotme dhe përgjatë gjithë kohës do të rekrutohen persona të rinj, me qëllim që çdo lagje të krijojë ekipin e saj dhe të zgjerohet më tej shtrirja e këtij projekti. Federata e Futbollit të Kosovës, përmes këtij angazhimi vazhdon të dëshmojë përkushtimin e saj për promovimin e sportit si një mjet të rëndësishëm në shëndetin publik dhe integrimin social”, ka njoftuar FFK-ja.

Ardian Ismajli mund të jetë gati për Serbinë

TIRANË, 2 TETOR - Mbrojtësi i Kombëtares së Shqipërisë, Ardian Ismajli, ka gjasë të mira që të luajë kundër Serbisë, ndeshje që luhet javën e ardhshme.

Ismajli është dëmtuar të hënën mbrëma në humbjen e Torinos nga Parma, ndërsa është konstatuar se nuk bëhet fjalë për një lëndim të rëndë. Bazuar në

shkallën e lëndimit të muskulit, Ismajli do t’i mungojë Torinos vetëm një ndeshje, atë kundër Lazios këtë vikend. Kështu që, gjasat janë të mira që Ismajli të

ftohet nga selektori i Shqipërisë, Sylvinho, për ndeshjet e këtij muaji, atë ndaj Serbisë në kuadër të kualifikimeve dhe miqësoren kundër Jordanisë.





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

 +386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Clean Solutions” SH.P.K. me seli në Obiliq, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811443704 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Clean Solutions” D.O.O. Obiliq donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811443704 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Clean Solutions” L.L.C. with headquarters Obiliq, has come to the decision to quit its business: 811443704 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



100% Fresh & Natural

VIDAS Llatte drink 2%

VIDAS TAMËL 2,8% PRODHUAR ME FINESE DHE DASHURI

VIDAS Schmand 18% yndyrë 800g ajkë o freskët sour cream 100% i Freskët Natural

VIDAS JOGURT 100% i Freskët Natural

VIDAS DHALLË 100% QUMËSHITI I FERMAVE TONA

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

